E hënë, 5 qershor 2023
[Seancë e hapur]
[I akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]
--- Seanca fillon në orën 09.30

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirëmëngjes dhe mirë se erdhët.

Znj. Sekretare, a mund të thërrisni çështjen ju lutem.

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-04, Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Së pari, do të kërkojmë që palët të paraqesin përbërjen e tyre.

Prokurori e ka fjalën.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mirëmëgjes, të nderuar Gjykatës. Për Prokurorinë është Line Pedersen, menaxhere e çështjes; Giulia Bianchi, konsulente ligjore; Gaia Pergolo, prokurore e asociuar; dhe Filippo de Minicis që është Prokurori.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Mbrojtja e Viktimave.

Z. LAWS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Unë jam Simon Laws, përfaqësoj viktimat në këtë çështje, jam së bashku me bashkëmbrojtësen Maria Radziejowska.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Faleminderit.

Mbrojtja, fjala për ju.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Mirëmëngjesi, të nderuar Gjykatës. Jemi këtu me z. Shala, i cili na ndjek me videolidhje. Unë jam z. Jean-Louis Gilissen dhe bashkë me mua është znj. Leto Cariolou, Hedi Aouini dhe menaxhere e çështjes Dzeneta Petravica, e cila është asistente e provave, ndërkohë që kemi gjithashtu edhe Camille Gosson, stazhiere; dhe Anita Dautaj, po ashtu stazhiere.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirëmëngjes, z. Shala. Më dëgjon mirë?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Mirëmëngjes. Ju ndëgjoj shumë mirë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sot do të organizojmë tre seanca të rregullta me një orë e gjysëm secila. Do të organizojmë dy herë një pushim prej 30 minutash dhe do të kemi dhe pushimin e drekës për një orë e gjysëm nga ora 13.00 deri në orën 14.30.

Përpara sesa të fillojmë me vazhdimin e marrjes në pyetje të Dëshmitarit numër 1, ju lutem a mund të na thoni sesa kohë mendoni që do t'ju nevojitet për të vazhduar me kundërpyetjet tuaja për dëshmitarin, Mbrojtës?

Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit, znj. Kryetare. Mirëmëngjes, të gjithëve.

Ne besojmë që do të përfundojmë sot. Megjithatë do të

varet sesa kohë do të na duhet, sa efikase do të jemi dhe çfarë përgjigjesh do marrim, megjithatë shpresojmë që deri në fund të ditës sot do të përfundojmë me marrjen në pyetje të Dëshmitarit 1.

Mund të përfundojmë në seancën e fundit, domethënë, kur flasë që do përfundojmë "sot" e kam fjalën që do të përfundojmë deri në seancën e fundit. Domethënë, nuk është e arsyeshme që të përfundojmë në seancën e parë ose seancën e dytë. Mbase mund të përfundojmë në seancën e pasdites, megjithatë përpara pushimit të drekës mund të jap më shumë informacion të hollësishëm me sa kohë na duhet deri në fund.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Tani do të vazhdojmë me dëshminë e dëshmitarit.

Znj. Asistente e Seancës, a mund ta sillni dëshmitarin në sallë ju lutem.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, mirëmëngjesi.

DËSHMITARI: Mirëmëngjes.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më dëgjon mirë?

DËSHMITARI: Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë. Si je sot?

DËSHMITARI: Mirë. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Shala, a konfirmoni që e dëgjuat dëshmitarin ju lutem?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, e ndëgjoj shumë mirë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sot do të vazhdojmë me marrjen tuaj në pyetje nga Mbrojtja. Do t'i jap fjalën Mbrojtjes për të vazhduar me pyetjet. Dhe ju kujtoj që jeni nën betim për të treguar të vërtetën.

DËSHMITARI: Po.

DËSHMITARI: TW4-01 [Vijon]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë. Në rregull.

Avokat i Mbrojtjes, e keni ju fjalën. Në qoftë se na duhet që të kalojmë në seancë private, ju lutem na thoni.

Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës. Po. Dëshirojmë që të kalojmë në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Znj. Sekretare, të lutem a mund të na kaloni në seancë private?

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Dëshmitar, tani do të bëni pushimin. Do shihemi përsëri në orën 11.30 mbase. Do të diskutojmë për disa çështje procedure ndërmjet palëve, kështu që mendojmë që është më mirë për ju që të nxirreni nga salla e gjyqit. Asistentja do ju ndihmojë. Faleminderit, për momentin do të shikohemi përsëri në orën 11.30.

DËSHMITARI: Okej.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj Asistente.

Avokat, e keni fjalën ju tani lidhur me çështjet e procedurës që dëshironi të ngrinit.

Z. AOUINI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike apo jo?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.

Z. AOUINI: [Përkthim] Atëherë duhet që të jem i kujdesshëm.

Dua t’ju them që ne do të tregojmë disa fotografi që i janë treguar dëshmitarit të cilat ai nuk i ka njohur dhe besojmë që një gjë të tillë mund ta bëj në seancë publike, pa përmendur pjesët e dokumenteve që bëjnë lidhjen e emrave me

fotografitë. Kjo është për referencë për juve. Dhe mund të përdorim referencat në transkript të cilat vërtetojnë që ai nuk i ka njohur këta personat e intervistuar.

Nëse na jepni leje, kjo është ajo se çfarë do të bëjmë, pra, çfarë do të ngremë. Dhe do t'i japim të drejtë dëshmitarit që të shprehet dhe në qoftë se ka më shumë hollësi të tjera për të dhënë, pastaj do të kalojmë në seancë private. Kjo është ajo çfarë doja të sqaroja me ju.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ky mund të jetë një udhëzim shtesë, megjithatë më lejoni t'i jap fjalën Prokurorit edhe Avokatit të Viktimave, që duhet ta udhëzojnë dëshmitarin që të përgjigjet me "po" ose "jo", sa i takon faktit në qoftë se e njeh personin që do t'i tregohet përmes fotografisë, pra, të thotë "po" ose "jo" pa dhënë hollësi të tjera.

Atëherë së pari më lejoni t'i jap fjalën Avokatit të Viktimave lidhur me këtë. Kjo është pika e parë.

Po pika e dytë?

Z. AOUINI: [Përkthim] Për ta plotësuar pikën e parë më lejoni të them që ideja është që të konfirmojë që ai nuk i ka njohur këta persona në 2019 dhe që nuk i njeh as sot e kësaj dite. Në qoftë se përgjigja për ndonjërën nga pyetjet është po, atëherë do kërkojmë që të kalojmë në seancë private. Do vijojmë siç u sugjerua prej jush, e nderuar, Gjykatëse, pra, do bëjmë pyetje të cilët do kërkojmë përgjigjen me "po" ose

"jo".

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë propozoj ndryshe, domethënë, a njihni këta persona të përgjigjet me "po" ose "jo" dëshmitari dhe në qoftë se përgjigja është e ndryshme nga përgjigja që ka dhënë në shkuarën, atëherë e vazhdojmë më tej, kërkojmë seancë të mbyllur apo jo?

Z. AOUINI: [Përkthim] Në rregull. Pika e dytë përderisa jemi në seancë publike, besojnë se kolegët e mi e kuptojnë se për çfarë e kam fjalën. Prokuroria ka pasur një kundërshtim në të shkuarën lidhur me faktin që dëshmitari di që persona të caktuar janë dëshmitarë.

Ne kemi një paragraf që na duhet që t'ia tregojmë dëshmitarit lidhur me një pikë konkrete që rrjedh nga dëshmia e një dëshmitari tjetër. Pengesa provuese dhe procedurale që kemi është që, në qoftë se ne i japin informacion që rrjedh nga dëshmia e dëshmitarit tjetër, atëherë na duhet që dëshmitarit t'i japim emrin e personit që e ka thënë këtë gjë në mënyrë që t'i japim mundësi të barabartë që të shprehet. Dhe në qoftë se nuk e themi se kush e ka thënë një të caktuar, atëherë nuk ka vlerë që ta pyesim, sepse në qoftë se i japim vetëm thjesht informacionin pa e thënë burimin e informacionit atëherë do e ketë të vështirë dhe nuk do ketë ndonjë logjik shumë të madhe që dëshmitari ta pranojë apo ta rrëzojë një deklaratë të tillë.

Mbase do më duhet që të kalojmë në seancë private për këtë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për këtë përpara do na duhet që të kalojmë në seancë private. Por përpara se ta bëjmë këtë gjë, preferoj që së pari të mbaroj me pjesën e pjesën e parë e cila mund të realizohet në publik.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Nuk ka problem. Ne e pranojmë atë çfarë u propozua nga kolegun lidhur me pikën e parë. Sa i takon pikës së dytë kemi diçka për të thënë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Avokat i Viktimave keni ndonjë gjë për të thënë lidhur me çështjen e parë?

Z. LAWS: [Përkthim] Jo. Nuk ka vështirësi për neve lidhur me pikën e parë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull.

Znj. Sekretare, ju lutem na kaloni në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Faleminderit. E zgjidhëm edhe pikën e dytë. Tani është ora pak më tepër sesa 11.00. do të bëjmë pushim për 30 minuta, do të takohemi përsëri në orën 11.30.

Seanca ndërpritet këtu.

--- Pauza fillon në orën 11.02

--- Seanca rifillon në orën 11.30

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se erdhët. Të shohim në qoftë se përbërja e ekipeve është e njëjta. E shoh që është e njëjta. Pra në të majtë janë të njëjtët persona që ishin paradite, po ashtu edhe në të djathtën time. Kjo u shënua për procesverbal.

Sa i takon pikës së dytë që diskutuam pa hyrë në hollësi dhe pa dhënë shpjegime të mëtejshme – z. Prokuror, dëshironi të thoni diçka.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Kemi një parashtrim që dua të përmblidhet me pikën e dytë. Edhe thjesht dua që të sigurohem që kjo është për procesverbal. Por na duhet që të kalojmë shkurtimisht në seancë private për ta diskutuar.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë, do ta bëjmë këtë. Znj. Sekretare, mund të na kaloni në seancë private, ju lutem.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë të hapur.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare. Tani do të vazhdojmë me marrjen në pyetje të dëshmitarit 1. Znj. Asistente e Sallës a mund ta sillni në sallë dëshmitarin ju lutem?

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se erdhët.

Z. Shala, e dëgjuat dëshmitarin?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po nuk ka fol dëshmitari gjë për me e ndigjue. Dëgjoj seancën.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull.

Z. Dëshmitar, a e thua dhe njëherë përgjigjen? Kam përshtypjen që thatë "faleminderit" apo jo?

DËSHMITARI: Po, thashë faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Shala po kësaj here e dëgjove dëshmitarin?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po e ndigjova shumë mirë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Faleminderit.

Tani do të vazhdojmë.

Z. Dëshmitar, do t'i jap fjalën Avokatit në mënyrë që të mund të vazhdojë me pyetjet e tjera që ka për ju.

Z. Avokat, e keni ju fjalën. Jemi në seancë të hapur.

Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar gjykatëse. Besojmë se duhet të kalojmë në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë, në rregull.

Znj. Sekretare, ju lutem të kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

Z. Avokat, e keni fjalën për të vazhduar me pyetjet, për t'i treguar fotografitë z. Dëshmitar. Ju lutem thoni numrat e identifikimit ERN për Sekretaren.

Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit e nderuar Gjykatëse.

Dokumenti është SITF00012895 deri në 00012913. Ju lutem le të kalojmë te fotografia. Pra ju lutem paraqisni fotografinë që jepet në faqen 19. Të shkojmë direkt tek faqja 19.
PY. Z. Dëshmitar, a njihni ndokënd nga këto fotografitë që të janë vënë përpara?
PË. Nuk po më duken të njohshme, jo.
Z. AOUINI: [Përkthim] Mund ta heqim nga ekrani këtë dokument dhe mund të kalojmë në një dokument tjetër. Me lejen tuaj të nderuar Gjykatës kërkoj që të paraqitet dokumenti ERN 059113 deri në 059144 direkt tek faqja 10 ju lutem.
PY. A e njihni këtë person?
KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E shikoni z. Dëshmitar? Është e vogël, është e madhe, doni ta zmadhojmë?
DËSHMITARI: Nuk po më kujtohet. S'po më kujtohet. Ndoshta e njoh po nuk po më kujtohet.
Z. AOUINI: [Përkthim] Do kërkoj që këtë dokument ta lëmë mënjanë dhe të shkojmë direkt tek faqja 14 pa kaluar njëra pastaj tjetrës. Kështu që ju lutem shkojmë në mënyrë të drejtpërdrejtë tek faqja 14 e këtij dokumenti.
PY. A e njihni këtë person z. Dëshmitar?
PË. Nuk po më kujtohet.
Z. AOUINI: [Përkthim] Vazhdojmë me faqen tjetër, faqen 15.
PY. E njëjta pyetje. A e njeh këtë person?

PË. Ky person po më duket sikur me u konë ai i anës së [REDAKTUAR] se ka qenë i maltrajtum atje në Kukës. Po më përngjan në të.

PY. Z. Dëshmitar, a konfirmoni që në vitin 2012 kur të kanë treguar këto fotografi ju nuk e keni njohur këtë fotografi, personin që është në këtë fotografi? Nëse keni informacion të gjatë për të dhënë domethënë në qoftë se keni plus “po” apo “jo” mund të kalojmë në seancë private. Pra a ju kujtohet që në 2012-n ta kanë treguar këtë fotografi dhe ke thënë që nuk e njeh?

PË. Unë nuk më kujtohet për atëherë, por që tash qysh jam tuaj e pa po më duket se është që ai i anës së [REDAKTUAR], [REDAKTUAR]. Se u konë i majtrajtum. Në të po më përngjan shumë. Shumë po më përngjan në të [REDAKTUAR]
[REDAKTUAR]
[REDAKTUAR].

PY. Mos jep më informacion. Ndoshta mund të kalojmë në seancë private në qoftë se dëshiron që të japë më tepër hollësi. Por pyetja ime është shumë konkrete. Ka të bëjë me 2019-n. Në qoftë se dëshironi mund të lexoj paragrafin nga deklarata e më përparshme.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kjo mund të bëhet në seancë publike?

Z. AOUINI: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju

lutemi mos përmendni datat, datën e deklaratës e kam fjalën.

Ju lutem vazhdoni më tej.

Do të lejoj për pak minuta të tjera në qoftë se do më lejojnë përkthyesit. Pra e shikoj që e konfirmojnë, kështu që mund të vazhdojmë për pak minuta të tjera.

Z. AOUINI: [Përkthim] Është dokumenti ERN 083219-TR-ET, Pjesa 8, e rishikuar. Është faqja 23 dhe po shohim rreshtat 13 deri në 16 të këtij dokumenti.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju lutem, vazhdoni znj. Sekretare.

Z. AOUINI: [Përkthim]

PY. Rreshti 13 thotë:

"Unë nuk e kam parë asnjëherë këtë person. Nuk e di kush është ky.

"Dhe pastaj në qoftë se mund të nënshkruani dhe të vendosni dhe datën dhe kjo do të jetë prova materiale numër 9."

Kjo është pjesa që doja të lexoja.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Edhe cila është pyetja?

Z. AOUINI: [Përkthim]

PY. E bëra pyetjen. Pyetja ishte kjo: A konfirmoni që nuk e keni njohur këtë person kur ju është treguar kjo fotografi më përpara, jo sot, por në atë momentin që nuk duhet ta përmendnim?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Propozoj që t’i bëjmë këtë pyetje dëshmitarit. A mund të komentoni se pse nuk e keni njohur këtë person në këtë fotografi atëherë?

DËSHMITARI: Trupi Gjykues, unë kam qenë edhe i smut prej syve edhe jam ala i smut. Nuk kam pasë as syza edhe s'i ka vërejt fort. Unë që dy vjet kam fillu me syza. I kam dy palë edhe për të leximit edhe për kështu. Mu që tash mu kujtu edhe prapë po them se mu po më përngjan shumë në atë personin që u konë palë e dëmtume se ka qenë në dhomë të teme edhe në atë zyrën. Nuk do me thonë se s'e kam njoft sot e nesër e po e njoh. Se kjo o memori, krytë i kam bajagi shumë të ngarkum.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në qoftë se të kuptova drejtë the që tani përdor syze dhe mund të shohësh më qartë se sa ke parë atëherë kështu?

DËSHMITARI: Po, se kam qenë shumë keq prej syve. Se syzat mjeku si mi ka dhonë i kam për në bazë nervore. Kur jam nervoz duhet me i mbajt. I mbaj dy tre orë derisa të qetësohet truni shoh ma mirë. Atëherë i hjeki se s'un i mbaj rregullisht se i kam prej mjekut. Se më ndikon në sy në bazë nervore, pamja.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Dëshmitar.

Avokat, a keni pyetje të tjera që kanë të bëjnë me këtë temë? Sigurisht domethënë që lejojmë që të vazhdoni me pyetje të tjera por nuk është e thënë që ta ndërpresim këtu. Mund të vazhdojmë me këtë pyetje edhe pas orës dy e gjysmë.

Z. AOUINI: [Përkthim] Jo, kam përfunduar me këtë temë, por thjesht kam një tjetër koment për procesverbal.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull.

Z. Dëshmitar, do bëjmë pushimin e drekës tani. Do të takohemi përsëri në orën 2.30. Mundohuni që të pushoni pak dhe do të shikohemi përsëri në orën 2.30. Faleminderit.

DËSHMITARI: Faleminderit edhe prej jush.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, Asistente e Seancës.

Avokat, komenti që dëshiron të bësh është koment që do ta bësh në seancë të hapur apo në seancë private?

Z. AOUINI: [Përkthim] Nuk mendoj që e identifikon atë që mund ta themi në seancë publike. Thjesht për të përmendur që dëshmitari kur iu përgjigj asaj pyetjeje nuk i kishte vënë syzet. Kaq kisha për të thënë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Përpara se sa të bëjmë pushimin e drekës, a ka diçka që dëshiron të thotë Prokuroria, Mbrojtja e Viktimave dhe Mbrojtja e të Akuzuarit?

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo, të nderuar Gjykatës.

Z. LAWS: [Përkthim] Jo, të nderuar Gjykatës.

Z. AOUINI: [Përkthim] Ndoshta një vlerësim të kohës që do të na duhet.

Besoj që do na duhet e gjithë seanca pasdite. Nuk e di në qoftë se do të kemi mundësi që të përfundojmë në seancën e pasdites sot apo nesër. Por dëshiroj të them që nuk është se kemi bërë shumë progres sa i takon ritmit ose le të themi kohës së përdorur. Thjesht sa për t'ju përditësuar.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit për përditësimin.

Në rregull atëherë. Bëjmë pushimin tani dhe do mblidhemi përsëri në orën 2.30.

--- Pauza e drekës fillon në orën 13.08

--- Seanca rifillon në orën 14.31

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Uluni, ju lutem. Mirë se jeni rikthyer.

Do të vijojmë tani me dëshminë, me pyetjet që do t'ja bëj Mbrojtja dëshmitarit. Në fund të ditës. Z. Prokuror, do ju pyes se sa kohë do t'ju duhet, në varësi edhe se ku do jemi atëherë, sigurisht, me pyetjet që do t'i bëjë Mbrojtja. ju pra edhe sa kohë do t'ju duhet që të bëni pyetjet tuaja plotësuese pas Mbrojtjes? Sepse Trupi Gjykues është i gatshëm që të miratojë kohën e nevojshme.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E njëjta vlen edhe për Mbrojtësin e Viktimave.

Në rregull atëherë. Sa i takon përbërjes, është e njëjta përbërje e ekipeve nga kjo anë.

Edhe për Mbrojtjen nuk ka asnjë ndryshim. Në rregull. Këtë e mbajtëm shënim.

Atëherë ka ardhur momenti që të sjellim dëshmitarin.

Zonja Asistente e sallës, ju lutem të shoqëroni dëshmitarin të hyjë në sallë.

hyjë në sallë. Faleminderit, zonja Asistente e sallës.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, mirë se erdhët.

DËSHMITARI: Mirë se ju gjeta.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë.

Z. Shala, konfirmoni nëse e dëgjoni dëshmitarin?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] [Mikrofoni çaktivizuar]

Z. AOUINI: [Përkthim] Mendoj se mikrofoni i z. Shala nuk ishte i ndezur.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Shala? Me sa duket mikrofoni nuk është i ndezur.

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Urdhënoni. Ju dëgjoj mirë. Unë mirë e dlgjoj.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. Në rregull.

Fjalën e ka Avokati i Mbrojtjes.

Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit, zonja Gjykatëse.

PY. Mirëdita, z. Dëshmitar.

PË. Mirëdita.

PY. Do të vijojmë me disa persona, individë, emra. E njëjta temë dhe pyetja tjetër është kjo që – ah pyetjen tjetër do ta bëjmë në seancë private. Më falni.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem na kaloni në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë e hapur.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit

Z. Dëshmitar, do ta ndërpresim këtu për sot. Ju falënderoj për dëshminë tuaj sot. Do të vazhdojmë nesër. Ju këshilloj që të pushoni. Mos flisni për dëshminë tuaj këtu me askënd. Do të ri shihemi nesër në orën 09.30. Faleminderit për sot.

DËSHMITARI: Faleminderit.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Avokat i Mbrojtjes, sa i takon kohës së përdorur, udhëzimet tona lidhur me këtë janë si vijon, pra lidhur me kohën faktike që përdor ZPS-ja. Pra pika e referimit nuk është koha që ka parashikuar, pra koha e parashikuar nga ZPS-ja. Megjithatë, do t'ja japim Mbrojtjes kohën që mendoni se është e domosdoshme, që në [e pakuptueshme] është domosdoshme, por pika e referimit është koha faktikisht e përdorur nga -- në këtë rast, nga ZPS-ja.

Është ora 16.00. Tashmë do të vijojmë nesër, por përpara se ta ndërpresim këtu seancën për sot, do të pyes palët nëse kanë ndonjë problem për të ngritur.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Asgjë hë për hë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Prokuror, nesër do të mbyllen në sesionin e parë kundrapyetjet e Mbrojtjes për dëshmitarin tuaj. ZPS-ja do të jetë e gatshme që të vijojë menjëherë me pyetje plotësuese apo do t'i duhet ca kohë për të lexuar se çfarë është thënë gjatë kundrapyetjeve?

Z. DE MINICIS: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, hë për hë mund të them se do të ishim të gatshëm që të vijonim me pyetjet plotësuese menjëherë pas palës Mbrojtëse. Dhe pyetjet plotësuese nga ana jonë s'besoj që do të jenë shumë të gjata. Besoj se brenda një gjysmë ore mund t'i japim fund çfarë do lloj pyetjeje përfundimtare por do të shohim edhe cilat anë

edhe temat e mbetura që ka ende pala Mbrojtëse dhe atëherë do ta mendojmë edhe një herë ofertën tuaj.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Prokuror.

Mbrojtësi i Viktimave, e njëjta pyetje. Së pari, keni ndonjë problem për të ngritur me Trupin Gjykues dhe së dyti, nëse jeni gati të vazhdoni menjëherë? Sa kohë ju duhet?

Z. LAWS: [Përkthim] Asgjë për të ngritur me ju. Faleminderit. Sa i takon kohës së nevojshme, ma merr mendja se Prokuroria jam i sigurt do të mbulojë gjërat më të rëndësishme, kështu që duke parë e duke bërë. po edhe po të na duhet ndonjë kohë për ndonjë pyetje, s’do jetë shumë e gjatë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Avokat, do ngrini ndonjë problem me Trupin Gjykues?

Z. AOUINI: [Përkthim] Asgjë nga ana jonë. Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Në rregull atëherë, ju uroj të gjithëve një mbrëmje të mirë. Këtu ndërpritet seanca.

--- Seanca mbyllet në orën 16.05